

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË  
TIRANË

NR. 2299 REGJISTRI  
Datë 25.02.2016 Regjistrimi

NR. 2710 VENDIMI  
Datë 31.05.2016

VENDIM  
"Në emër të Republikës"

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e përbërë nga:

**Gjyqtari Avni SEJDI**

Asistuar nga sekretaria gjyqësore **Griselda DORESI**, në Tiranë sot me datë 31.05.2016, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen administrative nr. 2299 akti me palë ndërgjyqëse:

**PADITËS:** Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, me adresë: Bulevardi "Zogu I" pranë Xhamisë Parrucë, Shkodër, përfaqësuar në gjykim nga Znj. Sirjana Bakushi me autorizim Nr. 2803/1 prot, datë 19.04.2016, identifikuar me letërnjoftim nr. 024589376.

**I PADITUR:** Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me adresë: Rr. "Gjin Bue Shpata", pranë Stadiumit "Selman Stërmasi", Tiranë, në mungesë.

Lazër Prela me NIPT K66324004F, me adresë: Lagjja "Partizani", Rruga "Europa", Godina 5-Katëshe, Kati I, Nr. 724 (bar kafe) Shkodër, në mungesë.

Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Tiranë, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizim i vendimit nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, vendim i cili ka shfuqizuar aktin administrativ Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. 12481 datë 06.11.2015.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

**BAZA LIGJORE:** Neni 31 i K. Pr. Civile; neni 7, 11, 15, 16, 17, 18, 21 i ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" neni 109 pika 3 e në vijim; Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, Ligji nr. 9136 datë 11.09.2013 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" i ndryshuar; Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar; Udhëzimi nr 5 datë 30.01.2006 "Për Tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar; Kodi i Procedurave Administrative; Kodi i Procedurës Civile.

Gjykata si mori në shqyrtim çështjen, si shqyrtoi dhe administroi provat e paraqitura nga palët, si dëgjoi bisedimet përfundimtare të tyre të cilët në përfundim kërkuan:

**Përfaqësuesja a palës paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, Znj. Sirjana Bakushi:**

Pranimin e kërkesëpadisë.


**Në mungesë të palës së paditur Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të paditurit Lazër Prela,** të cilët ndonëse kishin dijeni rregullisht për ditën dhe orën e gjyimit, pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk u paraqitën.

Gjykata si shqyrtoi aktet dhe e bisedoi në tërësi çështjen.

## VËREN

Paditësi Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar sipas objektit.

Gjykata, në mbështetje të nenit 7 gërma "a" 10/1, dhe 11/1 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si dhe 36 të Kodit të Procedurës Civile, kryesisht konstaton se, është



kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore për gjykimin e kësaj çështje dhe se mosmarrëveshja në fjalë bën pjesë në juridiksionin gjyqësor.

Për të bërë të mundur përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit në këtë gjykim, në zbatim të nenin 79/a të K.Pr.Civile, kërkesëpadia dhe aktet i`u njoftuan Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë, e cila me relacion të datës 24.03.2016, ka njoftuar mospjesëmarrjen e saj në këtë gjykim dhe delegimin e të drejtës së përfaqësimit dhe mbrojtjes institucionit përkatës, kjo bazuar në nenin 5, paragrafi i parë, pika "b" të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për avokaturën e shtetit", si dhe urdhrin nr. 34, datë 01.04.2010 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, duke qenë se objekti i padisë ka të bëjë me një konflikt brenda administratës publike.

- Rrethanat e çështjes:

I padituri Lazër Prela është regjistruar si person fizik pranë QKR-së dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër me NIPT K66324004F, me adresë të ushtrimit të aktivitetit Lagjja "Partizani", Rruga Europa, Godinë 5-katëshe, Kati I, Nr. 724, Shkodër dhe ushtron aktivitet tregtar "Bar Kafe".

Në datën 09.09.2015, inspektorët e Verifikimit në Terren të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, bazuar në urdhrin e punës nr. 503/1 prot, datë 09.09.2015, kanë ushtruar kontroll në vendin e ushtrimit të biznesit të të paditurit Lazër Prela ndodhur në adresën e sipërcituar dhe kanë mbajtur akt-konstatimin nr. 0546632 datë 09.09.2015, në të cilin ndër të tjera thuhet:

*"Subjekti është i regjistruar në QKR me NIPT K66324004F dhe Nr. serial SN-260297-12-14. Në momentin e kontrollit në punë u gjend Lazër Prela dhe një person që nuk identifikohet. Pajisja fiskale është në gjendje pune dhe lëshon kupon tatimor me nr. seria BN030007433. Nuk ka pajisje jofiskale. Është i afishuar posteri për detyrimin e marrjes së kuponit tatimor. Ka të afishuar listën e çmimeve. Konstatimi u mbajt në orën 12:00"*

Bazuar në këtë akt-konstatim nga pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër është përpiluar procesverbali nr. serie 0492202 datë 09.09.2015, sipas të cilit i padituri në këtë proces Lazër Prela dënohej me 50.000 lekë gjobë për kundërvajtjen administrative të mosdeklarimit të punonjësit të parashikuar nga neni 119 pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë."

Në vijim, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër ka nxjerrë aktin administrativ "Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore" nr. 12481 prot, datë 05.11.2015, për gjobë në vlerën 50.000 lekë, për "Mosdeklarim punonjësi".

Ndaj këtij akti, tatimpaguesi Lazër Prela ka paraqitur ankim administrativ, pranë Drejtorisë së Apelitit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila me vendimin nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 ka vendosur; shfuqizimin e gjobës në shumën 50.000 lekë të përcaktuar në aktin administrativ "Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore" Nr. 12481 datë 06.11.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.

Duke mos qenë dakord me këtë vendimmarrje të Drejtorisë së Apelitit Tatimor, pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, i është drejtuar me kërkesëpadi gjykatës duke kërkuar sipas objektit.

- **Pretendimet e palëve**

#### **Paditësi:**

Në kërkesëpadinë e paraqitur për gjykim si dhe gjatë gjykimit nga pala paditëse u pretendua si më poshtë:

1. Grupi i punës së kontrollit tatimor pranë DRT Shkodër në bazë të Urdhrit të punës nr. 503/1 datë 07.09.2015, ka ushtruar kontroll në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të subjektit Lazër Prela dhe ka mbajtur akt-konstatimin nr. serie 0516632 datë 09.09.2015, nga ku ka rezultuar se në punë është gjendur Lazër Prela dhe një person tjetër i cili nuk ka pranuar të identifikohet. Nga grupi i kontrollit është bërë verifikimi i të gjithë punonjësve të deklaruar si të punësuar nga subjekti para organit tatimor deri në atë kohë. Në bazë të praktikës hetimore administrative të ndjekur është vlerësuar se ndër punonjësit e gjendur në punë në ditën e konstatimit nuk është deklaruar në organin tatimor konform afateve dhe rregullave ligjore punonjësi i cili nuk ka pranuar as të identifikohet. Për këtë arsye subjekti është penalizuar me gjobë sipas procesverbalit nr. serie 0492202 datë 09.09.2015 dhe "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" Nr. 12481 datë 06.11.2015.

2. Mbi bazën e një urdhri tjetër pune, atij me nr. 537/13 datë 13.10.2015 pranë këtij subjekti është ushtruar një tjetër kontroll nga organi tatimor për të cilin është mbajtur akt-konstatimi me nr. serie 0528733 datë 13.10.2015, sipas të cilit në punë janë gjendur Lazër Prela dhe Jozef Prela, tashmë të deklaruar pranë organeve tatimore. Drejtoria e Apelitit Tatimor në vendimmarrjen e saj është bazuar jo në akt-konstatimin e parë, atë me nr. serie 0516632 datë 09.09.2015, por në akt-konstatimin e dytë atë me nr. serie 0528733 datë 13.10.2015 duke vendosur shfuqizimin e gjobës.

3. Vlerësimi tatimor me gjobë adresuar subjektit tatimpagues Lazër Prela nuk është bazuar në akt-konstatimin me nr. serie 0528733 datë 13.10.2015, por në akt-konstatimin nr. serie 0516632 datë 09.09.2015, në bazë të të cilit është mbajtur edhe procesverbali i gjobës me nr. serie 0492202 datë 09.09.2015. Mbi bazën e këtyre akteve dhe fakteve të konstatuara është bërë vlerësimi tatimor i pasqyruar në Njoftim Vlerësimin nr. 12481 datë 05.11.2015. Nga ana e DAT janë vlerësuar gabimisht provat, duke nxjerrë konkluzion të gabuar nga faktet, për pasojë duke nxjerrë një vendim në zbatim të gabuar të ligjit.

- Analiza e provave në lidhje me faktin dhe ligjin e zbatueshëm:

Në lidhje me legjitimitimin e palëve:

Sipas nenit 32 të K.Pr.Civile padia mund të ngrihet:

- a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur.

Në kuptim të kësaj dispozite procedurale civile, që të justifikohet ligjërisht kërkitimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, kjo duhet të bëhet vetëm prej atij që i përket sipas ligjit e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti (*legjitimim aktiv*) dhe vetëm kundra atij që me veprën e tij, mohon ose shkel të drejtën e kërkuarit (*legjitimim pasiv*).

Interesi i ligjshëm gjendet i pasqyruar dhe në dispozita të tjera procedurale që rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Kështu sipas **nenit 15 të ligjit nr. 49/2012** "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të drejtën e ngritjes së padisë e ka:

- a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik;

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave procedurale del se personi fizik apo juridik mund të kërkojnë zgjidhjen e konfliktit administrativ nëse plotësohen apo përmbushen dy kushte:

Së pari: akti administrative duhet të jetë i paligjshëm.

Së dyti: paditësi të jetë cënuar në interesat e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Legjitimiteti i palës në një proces gjyqësor nënkupton interesin legjitim dhe të vërtetë që duhet të ekzistojë ndërmjet palës dhe çështjes në shqyrtim.

Neni 32 i K.Pr.Civile, si dhe neni 15 i ligjit nr.49/2012, e kondicionon të drejtën e paditësit për të ngritur padi me interesin e ligjshëm që duhet të ketë ai për njohjen ose rrezimin e një pretendimi. Interesi i ligjshëm lidhet me të drejtën e palës për të kërkuar nëpërmjet gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të cënuar prej dikujt tjetër.

**Ligji i posaçëm nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar në neni 109, pika 3 të tij, ka parashikuar se; "Administrata tatimore, e cila ka nxjerrë vendimin administrativ, objekt ankimi, mund ta apelojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim".**

Sa më sipër, bazuar në nenin 32/a të K.Pr.Civile, nenin 15/a të ligjit nr. 49/2012 dhe nenin 109 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar, pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, gëzon legjitimitet aktiv në këtë gjykim, për të kundërshtuar aktin administrativ objekt gjykimi, Vendimin nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Po ashtu, pala e paditur, Drejtoria e Apelimit Tatimor në DPT, gëzon legjitimitet pasiv në këtë gjykim, pasi akti administrativ i sipërcituar i kundërshtuar për pavlefshmëri, objekt i këtij gjykimi, është nxjerrë pikërisht nga ky organ.

Sa më sipër si paditësi, ashtu dhe pala e paditur gëzojnë legjitimitet aktiv dhe pasiv në këtë gjykim.

#### **Në lidhje me juridiksionin:**

Sipas neni 137, paragrafi 3-te të K.Pr.Administrative, (*ankimi administrativ*) "Në parim palët e interesuara mund ti drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrative".

Po ashtu, **ligji i posaçëm nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"** në nenin 16 pika 1 të tij, ka parashikuar si kusht shterimin e ankimit administrativ para se subjekti ti drejtohet gjykatës.

Sipas pikës 2 të nenit 16 të ligjit të sipërpërmendur, përjashtohen nga ky rregull rastet kur:

a) ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;

b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë;

c) organi më i lartë në shqyrtimin e një ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedimin administrativ.

**Ligji i posaçëm nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar në neni 109, pika 3 të tij ka parashikuar se; "Administrata tatimore, e cila ka nxjerrë vendimin administrativ, objekt ankimi, mund ta apelojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijani për këtë vendim".**

Nga sa shihet, ligji i posaçëm, ai me nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, ka parashikuar se administrata tatimore e cila ka nxjerrë vendimin administrativ, objekt ankimi, mund ta apelojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor drejtpërdrejt në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijani për këtë vendim".

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 16, pika 2, germa "b" të ligjit nr. 49/2012 *Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" paditësi legjitimohen për t'iu drejtuar drejtpërdrejt gjykatës me padi për të kërkuar rivendosjen e së drejtës së saj të pretenduar, si të shkelur apo cënuar nga pala e paditur dhe se çështja në fjalë bën pjesë në juridiksionin gjyqësorë.

#### **Në lidhje me paligjshmërinë e aktit administrativ të pretenduar:**

Ashtu siç u citua më sipër, në datën 09.09.2015 inspektorët e Verifikimit në Terren të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, bazuar në urdhrin e punës nr. 503/1 prot, datë 09.09.2015, kanë ushtruar kontroll në vendin e ushtrimit të biznesit të të paditurit Lazër Prela dhe kanë mbajtur akt-konstatimin nr. 0546632 datë 09.09.2015, në të cilin ndër të tjera thuhet:

*"Subjekti është i regjistruar në QKR me NIPT K66324004F dhe Nr. serial SN-260297-12-14. Në momentin e kontrollit në punë u gjend Lazër Prela dhe një person që nuk identifikohet. Pajisja fiskale është në gjendje pune dhe lëshon kupon tatimor me nr. seria BN030007433. Nuk ka pajisje jofiskale. Është i afishuar poster i detyrimit të marrjes së kuponit tatimor. Ka të afishuar listën e çmimeve. Konstatimi u mbajt në orën 12:00"*

Bazuar në këtë akt-konstatim nga pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër është përpiluar procesverbali nr. serie 0492202 datë 09.09.2015 sipas të cilit i padituri në këtë

proces Lazër Prela dënohej me 50.000 lekë gjobë në kundërvajtje administrative të mosdeklarimit të punonjësit të parashtetuar nga pala e kërkuarës pika I gërma "b" të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë."

Në vijim, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, ka nxjerrë aktin administrativ "Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore" nr. 12481 prot, datë 05.11.2015, për gjobë në vlerën 50.000 lekë për "Mosdeklarim punonjësi".

Ndaj këtij akti, tatimpaguesi Lazër Prela, palë e paditur në këtë gjykim, ka paraqitur ankim administrativ, pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila me vendimin nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 ka vendosur; shfuqizimin e gjobës në shumën 50.000 lekë të përcaktuar në aktin administrativ Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore Nr. 12481 datë 06.11.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.

Pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër nuk është dakord me vendimmarrjen e palës së paditur, për këtë arsye i është drejtuar me kërkesëpadi gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e vendimi nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Në lidhje me sa u pretendua nga ana e palëve në këtë gjykim, gjykata, referuar rrethanave të faktit, provave të shqyrtuara në seancë gjyqësore si dhe shkakut ligjorë të padisë, çmon se kërkimet e palës paditëse janë të bazuara në ligj duke arsyetuar si më poshtë:

Mosdeklarimi i punonjësve në organin tatimor, përbën shkelje administrative dhe penalizohet me gjobë, sipas **nenit 119 paragrafi i parë gërma "a" i ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, në të cilin parashikohet:

*"Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:*

- a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh;"*
- b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.*

Nga pala paditëse pretendohet se Vendimi nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, i referohet akt-konstatimit me nr. serie 0528733 datë 13.10.2015,

ndërkohë që "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" nr. 12481 prot, datë 05.11.2015 është nxjerrë në bazë të akt-konstatimit nr. serie 0516632 datë 09.09.2015.

Referuar "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" nr. 12481 prot, datë 05.11.2015, rezultoi se në fund të tij thuhet se ky akt është konceptuar në vijimësi të urdhrit të punës nr. 503/1 prot, datë 09.09.2015.

Urdhri i punës nr. 503/1 prot, datë 09.09.2015 është pikërisht urdhri i punës të cilit i referohen inspektorët e palës paditëse DRT Shkodër, në akt-konstatimin nr. serie 0516632 datë 09.09.2015, çka do të thotë se "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" nr. 12481 prot, datë 05.11.2015 është nxjerrë në bazë të rrethanave të faktit të pasqyruara nga inspektorët në akt-konstatimin nr. serie 0516632 datë 09.09.2015 dhe jo në akt konstatimin me nr. serie 0528733 datë 13.10.2015, sikurse i është referuar pala e paditur DAT.

Në akt-konstatimin nr. serie 0516632 datë 09.09.2015 ndër të tjera thuhet: "*Në momentin e kontrollit në punë u gjend Lazër Prela dhe një person që nuk identifikohet.*"

Ndërsa në Vendimin nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor ndër të tjera thuhet: "*Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur kërkesës për apelim, konstatohet se në akt-konstatimin e mbajtur me datë 13.10.2015 nga inspektorët e kontrollit është cituar se në punë u gjet Lazër Prela dhe Jozef Prela*"... duke iu referuar kështu akt-konstatimit me nr. serie 0528733 datë 13.10.2015.

Sa më sipër, me të drejtë nga pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër është kërkuar shfuqizimi i Vendimit nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pasi rezultoi se ky vendim është marrë në kundërshtim me rrethanat e faktit mbi bazën e të cilave është ndëshkuar i padituri Lazër Prela, rrethana këto të pasqyruara në akt-konstatimin nr. serie 0516632 datë 09.09.2015, mbi bazën e të cilit është nxjerrë "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" nr. 12481 prot, datë 05.11.2015, i cili ka qenë objekt shqyrtimi nga ana e Drejtorisë së Apelit Tatimor.

**Sipas nenit 115 të K.Pr.Administrative, pavlefshmëria e akteve administrative ndahet në:**

- a. akte administrative absolutisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim flagrant me ligjin).
- b. akte administrative relativisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin).

Një ndërkombëtare e vlerësime midis dy llojeve të pavlefshmërisë është shkalla apo rëndësia e shkeljes së ligjit. Aktet administrative relativisht të pavlefshme janë të një shkalle më të ulët në drejtim të shkeljes së ligjit dhe të pasojave juridike që ato sjellin. Në aktet relativisht të pavlefshme rëndësia e shkeljes së ligjit nuk është e natyrës së inkompetencës së organit ose shkeljeve të rënda proceduriale. Aktet relativisht të pavlefshme mund të evidentohen për mospërputhje me përmbajtjen dhe qëllimin e ligjit, që në pjesën më të madhe mund të ndodhin për arsye të moskuptimit të qartë të ligjit ose interpretimit të gabuar të tij.

Parë në këtë këndvështrim, akti administrativ objekt gjykimi, Vendimi nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 i Drejtorisë së Apelit Tatimor, është akt administrativ relativisht i pavlefshëm pasi është nxjerrë nga pala e paditur Drejtoria e Apelit Tatimor pranë DPT-së në kundërshtim me rrethanat e faktit dhe në zbatim të gabuar të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH".

Përfundimisht nga sa u analizua më sipër, gjykata arrin në përfundimin se kërkesëpadia e paraqitur nga pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër duhet pranuar duke vendosur; shfuqizimin e Vendimit nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me të cilën është vendosur shfuqizimi i aktit administrativ "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" nr. 12481 prot, datë 05.11.2015 i DRT Shkodër.

**Sipas nenit 45 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nuk lejohet ankimi ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:**

- a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi;
- b)

**Sipas VKM nr.573 datë 03.07.2013, paga minimale në shkallë vendi është 22.000 (njëzet e dy mijë) lekë.**

Referuar Vendimit nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 i Drejtorisë së Apelit Tatimor i cili ka ndryshuar "Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore" nr. 12481 prot, datë 05.11.2015 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, rezulton se i padituri Lazër Prela është dënuar me gjobë në shumën 50.000 lekë, shumë kjo që rezulton të jetë më e vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, çka do të thotë se ky vendim është i paankimueshëm, kjo në bazë të dispozitës ligjore të sipërcituar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ky vendim është i paankimueshëm, dhe merr formë të prerë nga data e shpalljes së këtij vendimi.

Gjithashtu, në dhënien e një vendimi përfundimtar, gjykata ka detyrimin ligjor për tu shprehur në lidhje me shpenzimet gjyqësore të kryera nga palët gjatë gjykimin.

**Sipas nenit 106 të K.Pr.Civile, taksa mbi aktet, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe shpërblimi për një avokat, n.q.s ka pasur të tillë, të paguara nga paditësi, i ngarkohen të paditurit në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata.**

Ndër shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësi janë: taksa e regjistrimit të padisë në shumën 3.000 lekë, shpenzime këto që në bazë të dispozitës procedurale civile të sipërcituar, i duhen ngarkuar palës së paditur Drejtoria e Apelit Tatimor.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 126 e 306 të K.Pr.Civile, si dhe në nenin 40/1, gërma "a" të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

### VENDOSI

- Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër.
- Shfuqizimin e Vendimit nr. 39244/1 prot, datë 29.01.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me të cilën është vendosur shfuqizimi i aktit administrativ "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" nr. 12481 prot, datë 05.11.2015 i DRT Shkodër.
- Shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësi në shumën 3.000 (tre mijë) lekë i ngarkohen palës së paditur DAT Tiranë.
- Në zbatim të nenit 45/a të ligjit nr. 49/2012, ky vendim është i paankimueshëm dhe i formës së prerë.
- Në zbatim të nenit 510/a të K.Pr.Civile ky vendim është titull ekzekutiv për pjesën që bën fjalë për shpenzimet gjyqësore dhe është drejtpërdrejt i ekzekutueshëm nga Zyra e Përmbarimit nga data e shpalljes së këtij vendimi.
- U shpall në Tiranë sot me datë 31.05.2016.

SEKRETARE  
Griselda DORESI

Dore

PULLE TARIFFE  
RISHQIPERISE  
SHIVALLËS SË  
GJYQITARI  
Avni SEJDI  
200  
LEKE  
717